



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 97 Prot.

Tiranë, më 30.1.2024

V E N D I M

Nr.9, datë 30.1.2024

PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SKEMËS SË FUNKSIONIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL GJATË PROCESIT TË MIRATIMIT TË STRUKTURËS SË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS VENDORE (BASHKI) PËR VITIN 2024 DHE NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS QË DO TË MBIKËQYRË KËTË PROCES

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (e ndryshuar), bazuar në Udhëzuesin në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe me qëllim asistencën e institucioneve të administratës vendore (bashki) gjatë procesit të miratimit të strukturës për vitin 2024,

V E N D O S A:

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (bashki) për vitin 2024.
2. Ngritjen e grupit të punës që do të mbikëqyrë këtë proces, me përbërje si më poshtë:

i. Arbana Basha

Drejtor i Përgjithshëm i Inspektimit dhe Mbikëqyrjes

| | |
|-------------------------------|--|
| ii. Enkelejda Hebibasi | Drejtor i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit |
| iii. Alda Xhaxhiu | Inspektor, Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ |
| iv. Behare Hoxha | Inspektor, Drejtoria e Mbikëqyrjes |

3. Grupi i Punës, për realizimin e kësaj detyre, mbështetur në orientimet e Udhëzuesit në lidhje me aplikimin e skemës së funksionimit të shërbimit civil, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore (*bashki*) për vitin 2024, autorizohet të komunikojë me të gjitha mjetet zyrtare të komunikimit me Departamentin e Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore që kanë lidhje me këtë proces.
4. Grupi i Punës mund të zhvillojë takime të përbashkëta, me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, për të diskutuar aspekte të ndryshme të administrimit të shërbimit civil në administratën vendore, me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të ligjit në këto institucione, si dhe mbështetjen e njësisë së administrimit të burimeve njerëzore.
5. Gjatë këtij procesi do të analizohen strukturat e institucioneve për të përcaktuar konkretisht pozicionet e punës që kryejnë funksione të shërbimit civil, bazuar në përshkrimet e punës.
6. Në çdo takim të zhvilluar me njësitë e qeverisjes vendore (*bashkitë*) dhe/ose institucione të tjera që kanë lidhje me këtë proces, grupi i punës do të mbajë procesverbalin përkatës, ku do të shënohen detyrat e lëna me afate konkrete dhe do të ndjekë zbatimin e tyre.
7. Nëse gjatë procesit do të jetë e nevojshme nxjerrja e akteve unifikuese, grupi i punës duhet t'i paraqesë Komisionerit propozimet konkrete nëpërmjet një relacioni.
8. Ky proces do të përmbyllet me një raport vlerësimi të hartuar nga grupi i punës.
9. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi anëtarët e grupit të punës të përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi, si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, t'ia njoftojë këtë vendim të gjithë anëtarëve të grupit

të, brenda 24 orëve nga miratimi i tij dhe të ofrojë asistencën e nevojshme logjistike për të mundësuar realizimin e këtij procesi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha